

RAPORTI I VECANTE I AUDITUESIT TE PAVARUR
Për auditimin ligjor të fondeve të përftuara dhe të shpenzuara
Fushata zgjedhore 2009
Periudha 28/05/2009 - 28/06/2009

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve !

Sipas Kontrates se dates 18.09.2009, jam caktuar nga Ju, per kryerjen e auditimit ligjor te detyrueshem te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara nga Partia Rrugë e Lirise per fushaten zgjedhore ne perputhje me ligjin 10019 date 29.12.2009 « Kodi zgjedhor i RSH » , ligjin 10091 date 05.03.2009 « Per auditimin ligjor , organizimin e profesionit te E.K.R. dhe K.M. » dhe ligjit 9228 date 29.04.2004 « Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare »

Une, kam audituar pasqyrën (bashkëlidhur) të fondeve të përftuara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë "RRUGA E LIRISE" për periudhën 28/05/2009 deri 28/06/2009.

Kjo pasqyrë është përgjegjësi e subjektit zgjedhor Rrugë e Lirise

Përgjegjësia ime , është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

U krye auditimi , në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ne reference te vecante me S.N.A. 800. Këto standarde kërkojnë që, të planifikohet dhe të kryehet auditimi për të marrë siguri të arësyeshme që pasqyra financiare e fondeve të përftuara dhe shpenzuara për fushaten zgjedhore te jene pa anomali materiale. Auditimi i kryer , përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrën financiare, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësime të rëndësishme të bëra nga drejtimi i partise Rrugë e Lirise si dhe vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës. Une cmoj se ky auditim përbën një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Politika kontabël e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave. Mbi këtë bazë, e ardhura njihet kur arkëtohet dhe jo kur fitohet, dhe shpenzimet njihen si të tilla kur paguhen dhe jo kur kryhen.

Me rezervën e arkëtimeve te fondeve jopublike ne shumen mbi 100 mije leke , jo ne llogarine bankare te celur nga subjekti zgjedhor konform nenit 90 « Regjistrim i fondeve

jopublike » te ligjit 10019 date 29.12.2008 « Kodi zgjedhor i RSH », por ne arken e ketij subjekti zgjedhor , pasqyra bashkëlidhur, e fondeve të përftuara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë "Rruga e Lirise", jep një pamje të vërtetë dhe të drejtë ne te gjitha aspektet materiale të fondeve të përftuara (ardhurave te arketuara) dhe të shpenzuara (pagesave te kryera) për fushatën zgjedhore 2009, në përputhje me bazën e arkëtimeve dhe pagesave, konform Ligjit nr. 9228 date 29/04/20004(i ndryshuar) « Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare »..

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Luljeta HASHO

Tirane 02.11.2009